



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

**PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E LICENCAVE LOKALE TE SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënie e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin nr. 2, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 30, datë 22.04.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv në allotmentet Fier, Berat dhe Korçë”, në muajin mars 2020 do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së aplikimeve për dhënie e licencave të shërbimit të programit audioviziv, si më poshtë:

1. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Berat.
2. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Fier.
3. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Korçë.

***Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II, 1001, Tiranë, brenda datës 05.06.2020.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënie e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin e AMA-s nr. 2, datë 16.01.2020, ku përfshihen kerkesat ligjore, ekonomike, teknike, programore etj,
- Pagesat për licencë;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

***Aplikimet do të hapen më datë 05.06.2020, ora 10.00, në mjediset e AMA-s ku aplikuesit apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.***